



www.qbz.gov.al

# Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 39

**Tiranë – E hënë, 19 dhjetor 2022**

## PËRMBAJTJA

|                                                                               | Faqe                                                                                                                                   |
|-------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Njoftim i Universitetit të<br>Sporteve të Tiranës nr. 2017,<br>datë 9.12.2022 | Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së një anëtari të Bordit të<br>Administrimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës..... 3 |





## NJOFTIM

Nr. 2017, datë 9.12.2022

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË NJË ANËTARI TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS**

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të Universitetit të Tiranës, në mbështetje të neneve 47 dhe 48 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të pikave 6 dhe 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 26.12.2018, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”, shpall thirrjen, për:

**- Fillimin e procedurave të përzgjedhjes së 1 (një) anëtari të Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, që përzgjidhet nga studentët e Universitetit të Tiranës.**

Bordi i Administrimit të institucionit të arsimit të lartë është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Funksionet kryesore të Bordit Administrativ janë:

a) garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;

b) me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;

c) me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;

d) vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;

dh) miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njërive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;

e) jep mendimin për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;

f) përcakton rregullat e shpërndarjes së të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;

g) është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorit dhe të personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;

h) emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;

i) miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t’i përcillet Senatit Akademik;

j) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit të hartuar nga rektorati.

**Kriteret për t’u emëruar anëtar i Bordit të Administrimit janë:**

a) të ketë integritet etik dhe profesional;

b) të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;

c) të mos jetë i dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë;

d) të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe të dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesave.

Aplikimi për pjesëmarrje në procedurën e përzgjedhjes së 1 (një) anëtari të Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve, përfaqësues të studentëve, duhet të përmbajë:

- kërkesë për pjesëmarrje në konkurrim;

- jetëshkrim, ku, ndër të tjera, të përshkruhen arritjet në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Arritjet e referuara nga aplikanti, në një apo disa nga këto fusha, të shoqërohen me kopje të noteruara të dokumenteve provuese;

- kopje të dokumentit të identifikimit;

- kopje të noteruar të diplomës së arsimit të lartë;

- kopje të noteruar të diplomës/certifikatës /dëshmisë së nivelit më të lartë të kualifikimit shkencor dhe/ose akademik;

- vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore, sipas formularit bashkëlidhur;

- vetëdeklarim për kushtet e konfliktit të interesave, sipas formularit bashkëlidhur.

Dokumentet për pjesëmarrje në procedurën e përzgjedhjes së 1 (një) anëtari të Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve,



përfaqësues të studentëve, do të dërgohen përmes shërbimit postar, në adresën:

*Universiteti i Sporteve të Tiranës  
Komisionit Institucional të Zgjedhjeve  
Tiranë*

Afati për dorëzimin e dokumentacionit fillon më datë **19 dhjetor deri më 23 dhjetor 2022.**

Lista paraprake e kandidatëve, që plotësojnë kriteret e përcaktuara më lart, do të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Sporteve të Tiranës, brenda datës 27 dhjetor 2022. Procesi i shqyrtimit të ankesave do të zhvillohet me datë 29.12.2022. Lista përfundimtare e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara në VKM-në nr. 782, datë 26.12.2018, të referuar më lart, do të shpallet në

faqen zyrtare të Universitetit të Sporteve të Tiranës, brenda datës 29 dhjetor 2022.

Data e votimit të studentëve për përzgjedhjen e kandidaturave që do t'i paraqiten ministrit të Arsimit dhe Sportit për emërimin e anëtarit të Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve, përfaqësues të studentëve, është **12 janar 2023.**

KOMISIONI INSTITUCIONAL I  
ZGJEDHJEVE  
KRYETAR  
**Denis Nuriu**  
REKTOR  
**Prof. dr. Agron Kasa**







Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.  
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2022